

Sigurimi I shendetit dhe aksidenteve

1. Sigurimi nga aksidentet personale

Nëse papritur ju ndodh një aksident, dëmtimi juaj do të jetë jovevtem shendetesor por edhe financiar. Per t'jua lehtësuar këtë situatë, INSIG ju ofron këtë sigurim për të mbuluar shpenzimet e trajtimit mjekësor.

Aksident quhet një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh në mënyrë rastësore pa vullnetin e Të siguruarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi Të siguruarin dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë ose dëmtime trupore të tij.

Me ndodhjen e aksidentit, përfitoni:

- Paaftësinë e përkohshme
- 100% të shumës së sigurimit për Paaftësinë e përhershme të plotë.
- Paaftësinë e përhershme të pjesëshme e cila llogaritet në % mbi shumën e sigurimit
- Shpenzimet mjekësore
- Trajtim mjekësor jashtë shtetit përfitojnë vetëm personat e siguruar me shumë sigurimi mbi 1000 000 leke.

Në rast të humbjes së jetës së personit të siguruar si pasojë e një aksidenti INSIG i paguan përfituesit 100% të shumës së sigurimit.

2. Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim

Per te gjithë ju që udhëtoni jashtë territorit të Shqipërisë. INSIG ofron kontratën e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim, e cila do të jetë shoqëruesja dhe garancia juaj gjatë udhëtimit.

Ky sigurim ju mbron nga:

- Të papriturat dhe problemet shëndetsore që mund t'ju ndodhin gjatë udhëtimit tuaj jashtë territorit të Shqipërisë.
- Kudo që të ndodheni dhe në çdo moment INSIG do të jetë pranë jush falë marrëveshjeve të tij me kompaninë CORIS Assistance e cila kryen asistencën mjekësore.

Ju përfitoni:

- Dëmshpërblim të shpenzimeve mjekësore dhe të shpenzimeve të emergjencës për dëmtime fizike dhe sëmundje nga të cilat nuk keni vuajtur më parë deri në shumën e sigurimit. 30000euro

- Dëmshpërblim për aksidente personale deri më 30 000 euro kur si rezultat i aksidentit ndodh, humbja e shikimit, paaftësia e përhershme e plotë ose humbja e jetës së personit.
- Mbulimin e shpenzimeve të riatdhesimit deri në shumën 30000euro kur kërkohet transportimi i të dëmtuarit në atdhe me një mjet specifik transporti.

Ku mund te paiseni me kete lloj sigurimi?

- Në çdo agjensi udhëtimi me të cilin INSIG ka kontratë.
- Primet variojne ne varesi te zones ku do te udhëtoni dhe diteve te qëndrimit

3. Sigurimi i Detyrueshem i Udhëtareve

A e dini se kur udhëtoni me tren jeni të siguruar? Së bashku me biletën e trenit ju keni blerë edhe një kontratë sigurimi.

Ju përfitoni:

- ▣ Shumen prej 200 000 lekesh,ne rast te ndodhjes se ndonje aksidenti gjate udhëtitimit tuaj me tren.

Në rast aksidenti INSIG ofron:

- Përfitimin për paaftësi të përkohshme totale i cili paguhet në masën 0.12 % të Shumës së Siguruar për çdo ditë paaftësie.
- Përfitimi për paaftësi të përkohshme të pjeseshme i cili paguhet në masën 0.03% të Shumës së Sigurimit për cdo ditë paaftësie.
- Përfitimi për paaftësi të përhershme të pjeseshme e cila llogaritet në përqindje mbi shumën e sigurimit.
- Përfitimin e Shumës së Sigurimit në rast të paaftësisë së përhershme totale.
- Nëse si rezultat i aksidentit ju humbisni jeten INSIG i paguan përfituesit tuaj 100 % të Shumës së Sigurimit.

4. Sigurimi Shëndetit dhe aksidenteve të Studentëve që studiojnë jashtë territorit të Shqipërisë

Studente!!! Gjatë periudhes së studimit ju mund të ndodheni përballe situatave të veshtira për jetën dhe shëndetin tuaj. INSIG garanton sigurinë financiare tuajën, duke ju ofruar këtë kontratë.

Nga ky sigurim ju përfitoni:

- Shpenzimet mjeksore si dhe ndihmën e menjëhershme deri në 30 000 Euro.
- Shpenzimet e riadhesimit ose të transportit special në rast dëmtimi trupor apo sëmundje, deri në 30 000 Euro.
- Përfitimin në rast të humbjes së Jetës prej 30 000 Euro.

5. Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve

Prinder!

- Ju do të ndiheni me të qete kur femijet tuaj të jenë siguruar. INSIG ka përgatitur këto kontrate sigurimi për të krijuar një kulturë sigurimesh tek brezi i ri.

Pse duhet t'a blini këtë kontratë?

- Qëllimi i saj është mbrojtja e Shëndetit dhe Jetës së të rinjve që nuk janë në marrdhenie pune.
- Sigurimi i nxenesve dhe studentëve është sigurim 1-vjecar. me një cmim simbolik prej

Ky sigurim përfshin një gamë të gjere mbulimesh:
Përfitimet nga aksidentet

- Përfitimi për frakturat e cila jepet me një shume të menjehereshme kur si shkak i një aksidenti ndodh thyerja e eshtrave të gjymtyreve të sipërme ose të poshteme.
- Shpenzimet spitalore dhe farmaceutike
- Përfitimi për sëmundjet kritike.
- Në rast të humbjes së dy prindërve njëkohësisht, përfitoni dyfishin e shumës së sigurimit.
- Përfitimi për humbjen e Jetës së të Siguruarit.

	Primi	Shuma e Siguruar
Nxenes	500 leke	200 000 leke
Studente	1000 leke	400 000 leke